

# Fëmija ynë hyn në kopshtin e fëmijëve

## Këshilla për prindërit



Së shpejti, fëmija juaj do të ndjekë kopshtin e fëmijëve. Hyrja në kopshtin e fëmijëve është një hap i rëndësishëm për ju si familje dhe një moment i madh. Me qëllim që ju të mund ta shoqëroni dhe ta përgatisni fëmijën tuaj mirë në këtë rrugë, ka këtu disa mendime dhe këshilla.

## Kështu mund ta përkrahni fëmijën tuaj

**Grupi i lojërave ose oferta të tjera parashkollore në grup për fëmijët:** Grupi i lojërave ofron mundësinë që të fitohen përvoja të para brenda një grupi.

**Pavarësi:** Përkrahjeni fëmijën tuaj në këtë, që ai të kryejë veprime në jetën e përditshme vetë, si p.sh. të vishet vetë dhe të shkojë në tualet pa ndihmë.

**Sjellja sociale:** Mundësojeni fëmijës suaj që të lidhë kontakte me fëmijë dhe të rritur të tjerë jashtë familjes.

**Rregulla dhe rite:** Ndiqmon, nëse fëmija juaj mëson dhe njeh rregulla dhe rite të rëndësishme dhe nëse mëson që t'i mbajë. Një rend i ditës i pandryshuar e bën të mundur, që fëmija të jetë i përgatitur mirë për jetën e përditshme në kopshtin e fëmijëve.

**Gjumi:** Sigurojani gjumë të mjaftueshëm. Jeta e përditshme në kopshtin e fëmijëve mund të jetë e lodhshme për fëmijët.

**Të ushqyerit:** Ushqejeni fëmijën tuaj në mënyrë të balancuar. Kini kujdes, që ai në mëngjes të pijë dhe/ose të hajë diçka.

**Shëndeti:** Shumë lëvizje përjashta i bën mirë fëmijës dhe e stërvit fizikisht për ndjekjen e kopshtit të fëmijëve. Lajmërohuni sa më parë tek pediatri, nëse veni re një veçori në shëndetin ose zhvillimin e fëmijës suaj.

**Jeta e përditshme:** Përkrahjeni fëmijën tuaj në rrugën e tij drejt pavarësisë. Merrni kohë. Lëroni fëmijën tuaj të marrë pjesë në jetën tuaj të përditshme dhe jepjani atij porosi të vogla, si p.sh. që të shtrojë tavolinën. Organizojeni kohën e përbashkët të lirë me variacione. Këto mund të jenë: të gatuar bashkë, të bëni ekskursione në pyll ose edhe të bëni punë krijuese dhe vizatime në shtëpi.

**Lozja:** Duke lozur lirshëm, fëmija juaj fiton shumë përvoja të çmuara. Kjo e nxit zhvillimin e përgjithshëm.

**Gjuha:** Bëni muhabet me fëmijën tuaj, dëgjojeni kur ai flet, tregojani atij histori dhe këqyrni bashkë me atë libra me figura.

**Hapat e mësimit:** Çdo fëmijë ka shpejtësinë e vet në të mësuarin. Shfaqni gëzim në atë, çfarë ai di tashmë dhe e lëvdoni atë — edhe për mundimet e tij dhe për hapat e tij të vegjël në të mësuarin. Gëzimi juaj për veprimtarinë e tij është nxitja më e mirë për zhvillimin e tij të mëtejshëm.

**Mediet me ekran (televizor, celular, lojëra kompjuterike etj.):**

Fëmijët e moshës 3 deri në 5-vjeç mund ta shfrytëzojnë medie me ekran të përshtatshme për moshën e vet deri në 30 minuta në ditë duke qenë të shoqëruar nga të rritur.

**Rruga për në kopshtin e fëmijëve:** Tregojani fëmijës suaj se ku ndodhet kopshti i fëmijëve. Ushtroni me të rrugën drejt kopshtit të fëmijëve. Me kalim të kohës, ai mund ta bëjë këtë rrugë në mënyrë të pavarur.

**Bashkëpunimi:** E ndihmon fëmijën tuaj, nëse edhe ju e njihni kopshtin e fëmijëve, nëse mbani kontakt të vazhdueshëm me personin edukues në kopshtin e fëmijëve dhe nëse bashkëpunoni me atë.

## Çfarë duhet të dini

### A është i paracaktuar momenti i hyrjes në kopshtin e fëmijëve?

Kopshti i fëmijëve duhet të ndiqet që nga fillimi i vitit të ri shkollor në atë vit, kur fëmija mbush katër vjet deri në datën 31 korrik. Personat me përgjegjësi prindërore mund të deklarojnë shtyrjen e hyrjes për një vit. Kopshti i fëmijëve zgjat dy vjet. Ndjekja është e detyrueshme.

Ju do të informoheni nga Komuna Shkollore me shkrim deri me datën 1 janar për hyrjen në kopshtin e fëmijëve. Me këtë informacion ju do të njoftoheni, që fëmija juaj quhet i regjistruar për kopshtin e fëmijëve, përderisa ju nuk deklaroni deri me datën 1 mars shtyrjen për një vit.

### Kur është një fëmijë gati për kopshtin e fëmijëve?

Në momentin e hyrjes në kopshtin e fëmijëve, fëmijët gjinden në shkallë të ndryshme zhvillimi. Të mbështetet secili fëmijë në zhvillimin e tij në mënyrë optimale, kjo qëndron në qendër të kopshtit të fëmijëve. Shkolla, prindërit dhe persona të tjerë referimi japin së bashku një kontribut të rëndësishëm për këtë.

### A ka përjashtime nga hyrja e rregullt në kopshtin e fëmijëve?

Për arsye të rëndësishme, hyrja në kopshtin e fëmijëve mund bëhet një vit më herët ose mund të shtyhet për një vit. Kontaktohuni për këtë me Komunën Shkollore.

Në rast nevoje, për vlerësimin e shkallës së zhvillimit të fëmijës mund të merret mendimi i degës «Psikologjia shkollore dhe shkollor».

### Çfarë mund të bëni ju kur ndiheni i/e pasigurt?

Komuna Shkollore ju ndihmon në pyetje për hyrjen në kopshtin e fëmijëve.

Në raste pasigurie në lidhje me zhvillimin emocional, social dhe intelektual, drejtohuni degës «Psikologjia shkollore dhe shkollor» ose drejtohuni pediatrit.

Në raste pyetjesh rreth zhvillimit fizik, drejtohuni pediatrit.

Në raste pyetjesh rreth zhvillimit gjuhësor, drejtohuni logopedes/logopedit të shkollës.

## Këshillimi i psikologjisë shkollore për prindër

### Zyrat rajonale

**Amriswil**, Kirchstrasse 1, 8580 Amriswil, 058 345 74 60

**Frauenfeld**, Grabenstrasse 11, 8510 Frauenfeld, 058 345 74 30

**Kreuzlingen**, Konstanzerstrasse 13, 8280 Kreuzlingen, 058 345 74 80

Më shumë informacione merrni tek: [www.av.tg.ch](http://www.av.tg.ch)

Nr. i artikullit 5800.98.01, 05/2018 | Albanisch